

26. Që mijëra të burgosur kanë marrë shpresë përmes dashurisë që u është treguar atyre në mënyra praktike (siç janë dhuratat e rrobave, sapuneve dhe sendeve të foshnjës); përmes programit “ Shpresë për ty”; Angli, Kamboxhia, Republika Demokratike e Kongos, Etiopia, Gana, Indonezia, Bregu i Fildishtë, Koreja, Liberia, Nepali, Paraguai, Afrika e Jugut, Tanzania dhe Tailanda.

27. Për mbështetjen e vazhdueshme financiare të programeve “Shpresë për ty”, shërbesës së lutjes dhe trajnimit të udhëheqësve nga individë, fondacione dhe shërbesa partnere të TWR-së. Vazhdoni të luteni për fonde për të filluar programet në gjuhë të reja. Një dëgjues në Mozambik shkroi: “Unë jam tashmë i krishterë, por mënyra se si po e përdorni Fjalën e Perëndisë në programin tuaj është e mahnitshme dhe prek zemrën time. Por po shkruaj, sepse nëna ime nuk e kupton gjuhën portugeze. A është e mundur që programi të bëhet në gjuhën Tsonga për gratë që nuk kanë shkuar kurrë në shkollë?”

28. Që mijëra dëgjues të “Shpresë për ty” kanë ndarë dëshmi për mënyrën se si programi i ka ndihmuar ata të rrisin fëmijë të shëndetshëm, të trajtojnë më mirë bashkëshortët e tyre, të përgatisin ushqim të shëndetshëm dhe të jetojnë për të nderuar Perëndinë.

29. Që udhëheqësit e komunitetit dhe mediat po i ekspozojnë përdhunimet, martesat e fëmijëve, trafikimin dhe praktikat kulturore e dëmshme dhe se po inkurajojnë liderat të bëjnë më shumë për t’i dhënë fund këtyre abuzimeve të tmerrshme.

30. Që vejjshave dhe jetimëve u janë dhënë radio, ushqime, veshje, kujdes shëndetësor, pagesa për shkollim dhe u është mësuar për dashurinë e Perëndisë. “Feja e pastër dhe pa njollë përpara Perëndisë dhe Atit është kjo: të vizitosh jetimët dhe të vejjat në pikëllimet e tyre dhe ta ruash veten të pastër nga bota.” (Jakobi 1:27).

Për 21 vjet TWR Shpresë për ty është ballafaquar me rrethanat e dhimbshme dhe traumatike me të cilat përballen shumë gra çdo ditë. Kulturat, familjet dhe fetë në mbarë botën margjinalizojnë gratë duke u atribuar atyre pak vlerë. Dhuna në familje, martesat e detyruara, analfabetizmi, poligamia dhe mungesa e kujdesit shëndetësor shkaktojnë një cikël të pafund varfërie. Gratë që vuajnë nga rrethanat e tmerrshme të një bote mëkatore duhet të dinë se Perëndia i sheh ato dhe kujdeset për to. Psalmi 34:18 thotë: “Zoti është pranë atyre që e kanë zemrën të thyer dhe shpëton ata që janë të shtypur në frymë”.

Falënderojmë Perëndinë që na lejon të bëhemi pjesë e asaj që Ai po bën. Mesazhi është i qartë: Krishti ka ardhur në dhembshuri të madhe dhe dashuri për të shërbyer shërimin dhe shpresën ndaj atyre që janë thyer dhe abuzuar. Çfarë mesazhi i mrekullueshëm për t’u shpallur grave që kanë nevojë për shpëtim!

Ne i japim lavdi Perëndisë që, ndërsa gratë ndajnë barrën e tyre dhe lutën për barrët e të tjerëve, ato përjetojnë paqe. Ndërsa ulen në heshtje dhe dëgjojnë Fjalën e Perëndisë të shpallur përmes radios ose media player, zbulojnë të vërtetën. Ndërsa marrin ndihmë praktike përmes trajnimit të aftësive, ato fitojnë pavarësinë. Ndërsa vizitojnë dhe inkurajojnë të burgosurit, të sëmurët dhe të vetmuarit, Perëndia lavdërohet. Dhe ndërsa gratë takojnë Jezusin, ato përjetojnë dashurinë e pakushtëzuar të Krishtit.

Programet audio të TWR-së (Shpresë për ty, Thesare të fshehura, Shpresa e ka një emër, dhe Zëri shërues) ofrojnë mësim praktik dhe shpirtëror. Më shumë se 62 000 ndërmjetësues në 120 vende lutën për të

Lavdëroni dhe falenderoni Perëndinë




Dëgjoni kalendarin e lutjes online në
twr-albania.com

Dëgjoni programin “Shprese per ty” në:

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunën ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe
17:00



Jepni lavdërime dhe falenderime ...

1. Që gratë në mbarë botën po lavdërojnë Perëndinë me jetën e tyre edhe kur rrethanat e tyre të vështira nuk ndryshojnë për mirë. "Jini gjithmonë të gëzuar. Lutuni pa pushim. Për çdo gjë falënderoni sepse i tillë është vullneti i Perëndisë në Krishtin Jezus për ju." (1 Thesalonikasve 5: 16-18).

2. Për sigurinë dhe praninë e Perëndisë, ndërsa drejtoresha e shërbesës globale të TWR, Dr Peggy Banks, udhëtoi në Afrikë, Azi, Evropë dhe Amerikë për të mentoruar ekipet tona globale për të ecur thellë në marrëdhënien tyre me Perëndinë.

3. Për anëtarët e TWR Shpresë për ty që ofrojnë mjete të cilat u japin mundësi grave të bëjnë dallimin në jetën e atyre që u qëndrojnë përreth. Ato përdorin mediata, bashkëveprimin e grupeve të vogla dhe zhvillimin e lidhshimit për të inkurajuar, pajisur dhe angazhuar gratë në lutje, duke dëgjuar, duke mësuar, duke u rritur dhe duke dhënë.

4. Për vullnetarët e rinj, praktikantët dhe stafin që ndihmojnë të mbajnë përgjegjësitë e shumta që sjell shërbesa Shpresë për ty e TWR-së. Në Kore, 35 vullnetarë shpërndajnë kalendarët e lutjeve në nëntë gjuhë dhe prodhojnë programet e Shpresë për ty në gjuhën koreane dhe vietnameze.

5. Për radiodramën "Thesareve të fshehura" që ndihmon gratë e shfrytëzuara dhe të trafikuar të përfytyrojnë dashurinë dhe faljen e Zotit. Falënderoni ata që sigurojnë fondet e nevojshme për blerjen e pajisjeve audio dhe për organizatat e krishtera që i shpërndajnë ato.

6. Për gratë dhe burrat nga e gjithë bota të cilët i dhanë zë programit të kalendarit të lutjes në gjuhën angleze në vitin e tij të parë. Falënderoni Perëndinë për programet e lutjes që dëgjohen edhe në Shqipëri, Brazil, Malavi, Afrikë të Jugut dhe vende të tjera.

7. Për restaurimin e ndërtesës ku ndodhet zyra e TWR Cary pas zjarrit në dhjetor 2017.

8. Që Programi "Shpresë për ty" është dëgjuar në 73 gjuhë në radio, internet, CD dhe media të tjera. Gjithashtu lavdëroni Perëndinë që radiodrama "Zëri shërues" (për viktimat e fistulës) në gjuhën Ari vazhdon të prekë jetë në Etiopi.

9. Për 21 vjet shërbim të TWR Shpresë për ty. "Shikoni midis kombeve dhe këqyrni, do të mbeteni të habitur dhe të shastisur, sepse unë do të kryej në ditët tuaja një vepër, që ju nuk do ta besoni edhe sikur t'jua tregonin." (Habakuku 1: 5).

10. Për gratë në Azinë Qendrore, Lindjen e Mesme, Azinë Jugore, Afrikën e Veriut dhe rajone të tjera që i kanë dhënë jetën e tyre Krishtit edhe kur ato e kanë ditur që anëtarët e familjes mund t'i vrasnin për shkak të kësaj.

11. Për mundësinë që gratë udhëheqëse të marrin pjesë në konferencën e parë të TWR Shpresë për ty, mbajtur në Bratislavë, për të bashkuar pjesëmarrëset me Zotin dhe me njëra-tjetrën.

12. Që nënat kanë mësuar se si të kujdesen më mirë për fëmijët e tyre; t'u mësojnë të vërtetat e Perëndisë dhe t'i udhëzojnë ata që të jenë pasues të Krishtit. Gratë në Shqipëri kanë shpërndarë radio diellore nënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në mënyrë që të mund të dëgjonin programin "Shpresë për ty".

13. Që ndërsa gratë luten përmes kërkesave mujore të lutjes "Shpresë për ty", ato fillojnë të shohin të tjerët nëpërmjet syve të Perëndisë dhe qëndrimet, veprimet dhe ndjenjat e tyre bëhen më shumë si Jezusi. "Mos bëni asgjë për rivalitet as për mendjemadhësi, por me përulësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se vetveten. Mos mendojë secili për interesin e vet, por edhe atë të të tjerëve. Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jezu Krishtin" (Filipianëve 2: 3-5).

14. Për qindra punonjës të TWR Shpresë për ty dhe vullnetarë në çdo kontinent të banuar - prodhuesit e programeve, koordinatorët e shërbesës, ekipin dhe pjestarët e grupit të lutjes, ndërmjetësuesit, teknikët e radios dhe skenaristët, si dhe për ata që vizitojnë dhe i shkruajnë dëgjuesve .

15. Që përmes TWR360 (twr360.org/twrwomenofhope) gratë mund të dëgjojnë të vërtetën e Zotit në arabisht, anglisht, farsi, somalisht, spanjisht, thai, turqisht dhe 10 gjuhë të tjera. Gjithashtu, Facebook, Skype, Tëitter dhe Instagram u mundësojnë shumë të tjerëve të ngarkojnë programet e Shpresë për ty dhe kërkesat mujore të lutjes në gjuhët e përdoruesve. Mijëra prej tyre kanë raportuar se janë mirënjohëse që dikush kujdeset dhe merr kohë për të dëgjuar dhe për t'u lutur me to.

16. Lavdëroni bashkë me gratë në Etiopi ndërsa gëzohen që tashmë kanë një kryeministër të ri, i cili është i krishterë. Këto gra kishin marrë pjesë në një event 40-ditor të lutjes për paqen në vendin e tyre, e cila përfshiu 80 grupe etnike me fetë, vlerat dhe praktikata e ndryshme. Lutuni për bashkëshorten e kryeministrit, Zinash Tayacheë, gjithashtu një besimtare, e cila bëri këtë deklaratë. "Zyra e Zonjës së Parë, në bashkëpunim me organet përkatëse, planifikon të punojë në zona që kanë nevojë për vëmendje, sidomos në lidhje me kequshqyerjen e fëmijëve, martesat e hershme, rrëmbimin, përdhunimin dhe gjymtimin femëror".

17. Që e vërteta dhe dashuria e Perëndisë shpallen përmes radios në Azinë Qendrore, Kinë, Indi, Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut, Korenë e Veriut dhe zona të tjera ku të krishterët përdiqen dhe misionarët nuk lejohen të hyjnë. Jetët po ndryshohen dhe kishat po formohen. Perëndia "është në gjendje që sipas fuqisë që vepron në ne, mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa kërkojmë ose mendojmë," (Efesianëve 3:20).

18. Që ekipi kroat i TWR Shpresë për ty panë një rritje të vizitave në faqen e tyre të Facebook dhe në faqen e internetit, ku dëgjuesit nga Kroacia, SHBA, Kanadaja, Australia dhe vendet evropiane morën shpresë.

19. Për mijëra njerëz të përfshirë në grupet e lutjes Shpresë për ty që takohen rregullisht për t'u lutur, për të arritur gratë dhe për të rrëgjillizuar në burgje, në pavijonet e maternitetit, në spitale, në jetimore dhe në qendrat e strehimit.

20. Që gratë po mësojnë të qepin, të bëjnë bizhuteri ose këpucë dhe të kultivojnë të korra për të shitur, në mënyrë që të mund të sigurojnë për familjet e tyre dhe të fitojnë dinjitet dhe respekt në komunitetet e tyre.

21. Që me ndihmën e TWR Singapore, ekipi i Nepalit ishte në gjendje të kujdesej për rreth 800 njerëz, kryesisht gra dhe fëmijë, në zonat e varfëra, duke ofruar kontrollë, ilace dhe vitamina.

22. Që Perëndia ynë i madh na tregon hirin dhe dashurinë e Tij çdo ditë. "Do të të kremtoj midis popujve, o Zot, do të këndoju lavdet e tua midis kombeve, sepse e madhe deri në qiell është mirësia jote, dhe e vërteta jote arrin deri në rete. U lartofsh mbi qiejtë, o Perëndi; lavdia jote shkëlqeftë mbi të gjithë tokën." (Psalmi 57: 9-11).

23. Për gratë dhe burrat që kanë gjetur shpëtim nëpërmjet Jezu Krishtit dhe forcën për ta bërë atë çdo ditë me ndihmën e programit "Shpresë për ty" dhe për grupet e lutjes Shpresë për ty

24. Për ata që kanë dalë vullnetarë për të përkthyer kalendarët mujorë të lutjes së Shpresë për ty , në mënyrë që të tjerët të luten me ne në më shumë se 100 gjuhë. Falënderoni për ata që i shpërndajnë, ndonjëherë duke udhëtuar nga fshati në fshat në motoçikletë, me autobus ose në këmbë.

25. Për pastorët, bashkëshortët, kryeplakët e fshatit dhe stafin e TWR që mbështesin dhe shërbejnë stafin e "Shpresë për ty" dhe për vullnetarët në mbarë botën.

Të lavdërojmë dhe të falenderojmë Perëndinë